



ECOKOSWOMEN

KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA		
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Dërguar më Dostavljeno	22.08.2025	
Nr. llog. Org. led.	Nr. Br.	Shtojcë - Prilog
02-016/01-0055410		
PODUJEVË - PODUJEVO		



Në mbështetje të Nenit 5 pika d), Nenit 58 pika a), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Statutin e Komunës së Podujevës Nr.[01-020/01-0050862/18] të datës 29.06.2018, palët lidhin këtë:

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI DHE BASHKËFINANCIMI NË MES TË

1. **Organizata ECOKOSWOMEN**, me seli në Prishtinë të cilën përfaqëson znj. **Magbule Hyseni**, tutje referuar si **EKW**;
2. **KOMUNA E PODUJEVËS**, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, z. **Shpejtim Bulliqi**

Neni 1

Objektivi i Memorandumit

Objektivi i këtij Memorandumi është ndarja e përgjegjësisë për zbatim të projektit për fushën e bujqësisë, më saktësisht ndarjen e sistemit të ujitjes pikë-pikë, mulqit dhe rezervuarit, në kuadër të projektit 'Fuqizimi i grave dhe komuniteteve që jetojnë në viset rurale të Kosovës', në vlerë 4.683.50 €. Projekti përkrahet nga SIDA, mbështetur nga We Effect, përmes EKW-së dhe Komunës së Podujevës.

Neni 2

Obligimet e palës së EKE-së

1. Pala EKW financon në vlerë monetare 1,750.00 €, shtatë (7) gra fermere në Komunën e Podujevës, si mbështetje direkte për zbatimin e aktivitetit në fjalë, në kuadër të projektit;
2. Zgjedhja dhe kontraktimin e kompanive për realizimin e granteve;

Neni 3

Obligimet e palës së së KP-së

1. Komuna participon me vlerë monetare 1,000 €, katër (4) gra fermere në Komunën e Podujevës, si mbështetje direkte për zbatimin e aktivitetit në fjalë, në kuadër të projektit.
2. Komuna merr përsipër që brenda 2 javëve pas nënshkrimit të këtij Momerandumi të transferojë në xhirollogarinë e organizatës në bankën Ekonomike më numër të llogarisë 1401000013536723.
3. Komuna merr përsipër që participimin ta dëshmoj me anë të fletëdëshmisë së transferimit të këtyre mjeteve brenda afatit të lartë caktuar në paragrafin 2 të këtij neni.
4. Përcjell listën e aplikuesve për grante të printuar dhe në formatin excel.
Listës duhe t'i bashkangjiten këto dokumente për secilin rast të propozuar, si:
 - Kopja e letërnjoftimit;
 - Dokument për pronësinë e tokës (tokë familjare, apo në shfrytëzim);
 - Gatishmëri (përvojë) për të punuar në bujqësi;
 - Gatishmëri për të përcjellur njohuritë e fituara të një person tjetër.

Neni 4

Obligimet e ndërsjella

1. Procedurat dhe kontaktet zyrtare deri në realizimin e projektit janë plotësues të këtij memorandum. Procedurat janë në vijim:
 - Caktimi i personave kontaktues, dhe të autorizuar për zhvillimin e procedurave të nevojshme;
 - Vizitat e të propozuarve prej të dyja palëve;
 - Përzgjedhja e përfituesve bëhet nga komisioni i vlerësimit, i përbërë nga dy përfaqësues të EKW-së dhe përfaqësues të KP-së, duke i përmbushur kriteret kryesore, si:
 - Dokument për pronësinë e tokës (tokë familjare);
 - Mosha: 18-55;
 - Gatishmëri (përvojë) për të punuar në bujqësi;
 - Gratë e viseve rurale;
 - Gatishmëri për të përcjellur njohuritë e fituara të një person tjetër.
 - Pjesëmarrje prej të dyja palëve në aktivitetet e projektit
 - Hartimi i raportit pas përfundimit të realizimit të aktivitetit.

Neni 5

Numri i kopjeve

Ky Memorandum i Mirëkuptimit është përpiluar në dy (2) ekzemplarë të njëjtë, prej të cilëve nga një (1) ekzemplarë i marrin palët nënshkruese.

Neni 6 **Vlefshmëria e Memorandumit**

1.Ky Memorandum miratohet nga data e nënshkrimit nga të dyja palët deri më 31.12.2025.

2.Çdo ndryshim në përmbajtjen e tij do të jetë i vlefshëm vetëm nëse regjistrohet në një shtojcë me shkrim në këtë Memorandum, i cili nënshkruhet nga të dy palët.

Neni 7 **Konfidencialiteti**

1.Palët do të mbajnë konfidencial çdo informacion të marrë me anë të bashkëpunimit të tyre, përfshirë në lidhje me informacionin mbi operacionet e EKW, partnerët dhe përfituesit.

2.Detyra e konfidencialitetit do të zbatohet edhe pas skadimit të këtij Memorandumi.

Neni 8 **Hyrja në fuqi**

Ky Memorandum paraqet vullnetin e lirë të palëve nënshkruese, të cilat zotohen se të njëjtin do ta zbatojnë me përpikëri dhe në pajtim me kornizën ligjore në fuqi, ndërsa obligimet e palëve rrjedhin pas nënshkrimit të këtij Memorandumi dhe i njëjti hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e palëve.

ECOKOS WOMEN

PP. SHIPRËJA GOSALCI
Magbule Hyseni



Komuna e Podujevës

Shpejtim Bulliqi
Shpejtim Bulliqi



Podujevë, 28.08.2025